



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

Procesverbali për mbajtjen e dëgjimit publik nga anëtarët e KPF-së

Ky procesverbal është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna me theks neni 30-Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Me 19.01.2024, kryetari i komunës së Prizrenit Shaqir Totaj, ka nënshkruar vendimin për formimin e grupit punues për përgatitjen e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për vitet 2025-2027 si dhe Projekt Buxhetin e Komunës së Prizrenit për vitin 2025. Përbërja e këtij grupi është: Zenel Ahmetaj, kryesues; Halil Lika, zëvendës kryesues; Gjafer Ponik, anëtar-procesmbajtës; Fejsal Hoti, anëtar; Naim Kukaj, anëtar; Ymer Berisha, anëtar dhe Haziz Krasniqi, anëtar.

Procesverbali:

Dëgjimi ka nisur në orën : 11:10

Hapja e dëgjimit është bërë nga Ymer Berisha, udhëheqësi i Njësisë për Komunikim me Publikun, i cili ka thënë se dhe sot sikur se edhe në dëgjimet tjera që mbajtura ne do ti dëgjojmë kërkesat tuaja që i keni dhe më pas ato kërkesa sipas prioriteteve do të hynë në buxhetin e vitit 2025, qytetarët që janë të pranishëm në dëgjim dhe kërkesat i kanë bërë gjatë dëgjimit në lokalitetet ku janë mbajtur dëgjimet, ju lus që të mos i përsëritini, përpos nëse keni kërkesa të reja..

Fillimisht kryesuesja e Kuvendit Komunal, Antigona Berisha Bytyqi përshëndeti dhe falënderoj të gjithë qytetarët e pranishëm për kontributin e dhënë në kërkesat e tyre për realizim të projekteve nga ana e komunës gjatë vitit 2025. Për mbajtjen e këtij dëgjimi public zyrtarët përgjegjës do të mbajnë procesverbal dhe to të hartojnë raport me të gjitha detajet.

Sulltan Badalli, drejtor për buxhet dhe financa ka thënë se buxheti i komunës së Prizrenit bazohet në qarkoren që e dërgon ministria e financave, ajo qarkore na i vendos edhe limitet buxhetore, për vitin 2025 buxheti i komunës së Prizrenit do të jetë 70,982,477.00, i ndarë në kategori si në vijim: Paga: 28,199,288.00; Mallra&Shërbime 14,240,244.00; Investime Kapitale 21,425,881.00; Shpenzime Komunale 1,055,299.00; Subvencione 4,561,785.0; Huamarrje 1,500,000.0.

Kërkesat e qytetarëve të pranuar gjatë dëgjimit publik:

Shukri Quni - Nashec

1. Kërkesat për ndreqim publik dhe kanalizim nuk janë përfshirë në buxhet
2. Te hiqen parat prej disa kodeve dhe të kalojnë në kodet për fshatrat Nashac-Kojush - Grazhdanik dhe mazrek.

Samidin Maqkaj - Lubiqeve

1. Lidhja e rrugës Jeshkov - Lubiqev – Lez
2. Rregullimi i kanalizimit të fshatit
3. Ndërtimi i shtëpish të kulturës
4. Hapja e rrugës që e lidhë fshatin Lubiqev me fshatrat e Opojes
5. Vendosja e një pllake përkujtimore në vendin ku është varrosur komandanti Remzi Ademaj

Bajram Kastrati – Lagjja Arbana

1. Rregullimi apo vendosja e sistemit të ngrohjes dhe ajrosjes në shkollë
2. Rregullimi i nyjeve sanitare nuk po bëhet si duhet puna
3. Rrethimi i varrezave në lagjen Arbana
4. Ndërtimi i kulmit të shkollës
5. Ndërtimi i dyerve dhe dritareve të bëhet në vitin 2025
6. Ndriçimi publik
7. Ndërtimi i qatave të kulmeve
8. Ndërtimi i sistemit të ujitjes

Hadije Thaqi

1. Mbulimi i fushës sportive në shkollën Ibrahim Fehmiu
2. Ndërtimi i dyshemeve

Kastriot Kelmendi – Lagjeja Arbana

1. Pastrimi i rrugëve
2. Rrethimi nga qentë endacak në lagje
3. Ndriçimi publik
4. Rregullimi i rrjetit elektrik

5. Probleme me tatimin ne prone pasi qe pronat nuk janë në emër te pronareve

Resmije Krasniqi

1. Ndërtimi i shtëpisë për invalidin e luftës

Veli Kelmendi – Lagjja Arbana

1. Zgjidhja e problemit me çështjet pronësore me AKP

Pajazit Hoxha – Lagjja Arbana

1. Zgjidhja e problemeve pronësore pasi po ngarkohen me tatim ne prone.

Dëgjimi ka përfunduar në orën: 12:30

Procesmbajtës:

Gjafer Ponik

Haziz Krasniqi